

# AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

çfarë janë - çfarë duhet të bëjmë - cilat janë të drejtat tuaja

Italisht

Anglisht

Frëngjisht

Spanjisht

Rumanisht

**Shqip**

Serbisht

Kroatisht

Arabisht

Kinezisht

**INAIL**

DIREZIONE REGIONALE PER IL PIEMONTE

Novembre 2005

# **INAIL**

**[www.inail.it](http://www.inail.it)**

Direzione Centrale Comunicazione  
00144 Roma - Piazzale Giulio Pastore, 6  
E-mail: [dccomunicazione@inail.it](mailto:dccomunicazione@inail.it)

**[www.inail.it/piemonte](http://www.inail.it/piemonte)**

Direzione Regionale Piemonte  
10137 Torino - Corso Orbassano, 366  
E-mail: [piemonte@inail.it](mailto:piemonte@inail.it)

# Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

## çfarë janë - çfarë duhet të bëjmë - cilat janë të drejtat tuaja

**Kjo broshurë përmban informacionet bazë për t'u shpjeguar punonjësve të drejtat e tyre kryesore në rast AKSIDENTESH OSE SËMUNDJESH TË SHKAKTUARA NGA PUNA**

Puna është e rëndësishme për të gjithë, por duhet të jemi shumë të kujdesshëm sepse ka rrezik të dëmtohemi. .

**Në qoftë se ndodh një aksident, duhet të dimë se çfarë duhet bërë dhe cilat janë të drejtat tona.**

Gratë dhe burrat që punojnë në Itali, edhe po të jenë të huaj, kanë të drejtat e tyre.

Në rast aksidenti ose sëmundje të shkaktuara nga puna, të drejtat u garantojnë gjithmonë edhe personave që nuk janë të siguruar ose që nuk mund të sigurohen sepse nuk kanë leje për të punuar në Itali.

Jam vrarë (plagosur) gjatë punës  
(mund të quhet një **aksident në punë**)

Kam pasur një aksident ndërsa po shkoja në punë  
(mund të quhet një aksident **duke shkuar në punë in itinere**)

Mjeku më ka thënë se sëmundja ime mund të jetë shkaktuar nga puna  
(mund të bëhet fjalë për një **sëmundje profesionale**)

**NË KËTO RASTE, PËR TË DITUR SE ÇFARË DUHET BËRË DHE PËR TË KËRKUAR NDIHMË, DUHET TË DREJTOHEMI NË INAIL**, Instituti Kombëtar për Sigurimet ndaj Aksidenteve në Punë (Istituto Nazionale per l'Assicurazione degli Infortuni sul Lavoro) dhe sëmundjeve profesionale.

Ligji italian parashikon që **TË GJITHË** punonjësit të sigurohen në INAIL për të pasur, në rast se plagosen ose sëmuren për shkak të punës, paratë, shërbimet shëndetësore, asistencën dhe, në rast vdekje, një ndihmë ekonomike për personat e familjes.

## **ÇFARË BËN INAIL?**

Administron sigurimin, e aksidenteve dhe të sëmundjeve nga puna, që është i detyrueshëm me ligj.

Në rast aksidentesh në punë ose sëmundjesh profesionale, INAIL-i ndërhyr duke i dhënë punonjësit një ndihmë ekonomike dhe shërbime të tjera.

INAIL-i përveç kësaj ndërhyr, së bashku me Entet e tjera, për parandalimin e rreziqeve në punë dhe për kujdesin, rehabilitimin dhe integrimin shoqëror të personave që janë dëmtuar fizikisht dhe/ose nga ana psikike për shkak të punës.

## **CILAT JANË BURIMET EKONOMIKE?**

Punëdhënësit duhet t'i sigurojnë të gjithë personat që punojnë në vartësi të tyre, **edhe nëse janë të huaj**, duke i paguar INAIL-it një shumë parash (**Çmim sigurues**).

Ky "Çmim" është krejtësisht në ngarkim të punëdhënësit.

## **NË RAST AKSIDENTI OSE SËMUNDJE QË ËSHTË SHKAKTUAR NGA PUNA, MBROJTJA E PUNONJËSIT ËSHTË GJITHMONË E GARANTUAR.**

Në qoftë se plagoseni ose sëmureni për shkak të punës, keni të drejtë të mbroheni nga INAIL-i dhe, sipas rastit, keni të drejtën e shërbimeve shëndetësore dhe ekonomike.

Shërbimet ju takojnë edhe në qoftë se punëdhënësi juaj nuk ju ka siguruar (kjo e drejtë quhet "**automatizëm i shërbimeve**")

### **CILAT JANË SHËRBIMET E INAIL?**

**INAIL-i, sipas rasteve të ndryshme u jep punonjësve, që kanë pësuar aksidente ose që kanë marrë një sëmundje profesionale, ndihmë (shërbime):**

- **ekonomike**
- **shëndetësore**
- **shërbime shtesë (për integrim shoqëror – pune)**

### **KU GJENDET INAIL?**

ka selinë e saj në qytetet kryesore italiane; në fund të kësaj broshure do të gjeni adresat e **Zyrave që gjenden në Rajonin e Piemonte-s (Regione Piemonte).**

## PËR TË NJOHUR MË MIRË TË DREJTAT TUAJA:

### **ÇFARË është**

- **aksidenti në punë**
- **aksidenti duke shkuar në punë**
- **sëmundja profesionale**

### **AKSIDENTI NË PUNË**

Ligji italian e quan se bëhet fjalë për “aksident në punë” në qoftë se punonjësi, për shkak të punës që po bën dhe për një arsye të dhunshme (për shembull: kur rrëzohet nga lart, goditet nga një objekt, shtypet nga një peshë, digjet nga zjarri ose nga një substancë kimike, plagoset nga një xham ose nga një llamarinë, etj.), pëson një dëm fizik dhe/ose psikik i cili e pengon të vazhdojë punën për një periudhë, pak a shumë të gjatë, e cila duhet të vendoset nga një mjek nëpërmjet dokumentit përkatës (**çertifikatë mjekësore për aksident në punë**).

### **AKSIDENTI DUKE SHKUAR NË PUNË**

Ligji italian e siguron punonjësën edhe për dëmet fizike dhe/ose psikike si pasojë e aksidentit që ka ndodhur gjatë rrugës **normale** vajtje dhe ardhje nga vendbanimi në vendin e punës (për shembull kur: përfshihet në një aksident rrugor, rrëshqet, rrëzohet, goditet nga një objekt, etj.).

**Edhe në këtë rast është e nevojshme çertifikata mjekësore e aksidentit.**

### **SËMUNDJA PROFESIONALE**

Për sëmundje profesionale kuptohet një sëmundje që ka ndodhur gjatë aktivitetit të punës për shkak të punimeve të bëra (për shembull: shurdhësi nga zhurmat, tumore të shkaktuara nga bojëra të veçanta ose ngjyruet, asbeste ose tumore të shkaktuara nga fibrat e amiantit, sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes të shkaktuara nga silici dhe agjentë të tjerë kimikë, etj.), por me kusht që të njihen nga një mjek, me dokumentin përkatës (**çertifikatë mjekësore për sëmundje profesionale**).

## ÇFARË DUHET BËRË?

### **Aksidenti në punë ose kur jemi duke shkuar në punë**

Lajmëroni vetë ose nëpërmjet dikujt tjetër punëdhënësin tuaj, ose personin e ngarkuar nga punëdhënësi.

Sipas rastit:

- drejtohuni te mjeku i ndërmarrjes në të cilën punoni, në qoftë se gjendet në vendin e punës;
- shkoni vetë ose të shoqëruar në shërbimin e "Ndihmës së Shpejtë" (Pronto Soccorso) pranë një spitali, që të jetë sa më afër nga vendi ku gjendeni;
- në qoftë se është e nevojshme thërrisni ju vetë ose me ndihmën e dikujt tjetër shërbimin e ambulancës në **numrin e telefonit 118**;
- drejtohuni te mjeku i juaj kurues.

Mjekut duhet t'i shpjegoni gjithmonë si dhe ku ka ndodhur aksidenti.

Mjeku lëshon të parën "**çertifikatë mjekësore**" në disa kopje.

Në çertifikatë është e treguar diagnoza dhe numri i ditëve të parashikuara fillimisht për mungesat nga puna për arsye aksidenti në punë.

Një kopje duhet t'i **dorëzohet menjëherë punëdhënësit** (direkt ose nëpërmjet personave të tjerë, të familjes ose miq), një kopje duhet **të ruhet nga punonjësi** (Kujdes! Fotokopjet e çertifikatës mjekësore nuk konsiderohen të vlefshme).

Në rast shtrimi, spitali do të marrë masa menjëherë për t'ia dërguar kopjen e çertifikatave INAIL-it dhe punëdhënësit.

Punëdhënësi, në qoftë se mjeku ka vërtetuar se punonjësi nuk mund të punojë për më shumë se tre ditë, duhet të lajmërojë menjëherë INAIL-in duke i dërguar zyrove kompetente kopjen e çertifikatës mjekësore së bashku me një formular të veçantë që quhet "**denoncim aksidenti**".

Në rast se punëdhënësi nuk e denoncon aksidentin në INAIL, punëdhënësi mund të lajmërojë direkt INAIL-in duke paraqitur pranë zyrave të Entit çertifikatën mjekësore.

## **Punonjësi duhet të fillojë punën në ditën e caktuar nga çertifikata mjekësore.**

Në qoftë se punonjësi mendon se nuk është shëruar akoma, ai mundet:

- t'u drejtohet mjekëve të INAIL-it pranë ambulatorëve të Selisë që gjendet më afër shtëpisë së tij, për lëshimin **falas** (pa pagesë) të çertifikatës mjekësore.

### **Ose**

- t'i drejtohet mjekut të vet kurues; çertifikata është me pagesë dhe INAIL-i do të paguajë një pjesë të shpenzimit, në qoftë se është i dokumentuar.

Mjeku vlerëson gjendjen e shëndetit të punonjësit dhe, sipas rastit, lëshon një çertifikatë shërimi klinik (**çertifikatë mjekësore përfundimtare**) ose një çertifikatë me shënimin e ditëve shtesë, të nevojshme për shërim (**çertifikatë mjekësore e vazhdueshme**). Pasi skadon afati i kësaj periudhe, punonjësi duhet të kthehet te mjeku i cili, në qoftë se vërteton shërimin, lëshon **çertifikatën mjekësore përfundimtare**.

**Gjatë periudhës së aksidentit punonjësi duhet t'i komunikojë INAIL-it ndërrimin e mundshëm të banesës.**

### **Sëmundja profesionale:**

Në qoftë se punonjësi kryen aktivitet pune, duhet t'i paraqesë punëdhënësit të parën **çertifikatë mjekësore të sëmundjes profesionale** dhe, në rast se mjekimet për shërim vazhdojnë, çertifikatat e tjera mjekësore.

Në qoftë se punonjësi kryen disa aktivitete, mund të paraqesë direkt në INAIL kërkesën për njohjen e sëmundjes profesionale së bashku me çertifikatën mjekësore të sëmundjes profesionale.

## CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

### Kompensimi ditor për paaftësi të përkohshme absolute:

Kur punonjësit i dëmtohet shëndeti për shkak të punës dhe mjeku parashikon se ai nuk do të shërohet brenda tre ditëve, INAIL i paguan punonjësit një shumë ditore parash, që quhet "**Kompensim i përkohshëm**", që zëvendëson pjesërisht, pagën (rrogën) në periudhën e mungesës në punë.

Ky kompensim merret duke filluar nga dita e katërt, pas ditës në të cilën ka ndodhur aksidenti dhe gjatë gjithë kohës që mjeku mendon se është e nevojshme, për shërimin ose për stabilizimin e gjendjes së shëndetit.

Kompensimi i përkohshëm llogaritet mbi pagën e deklaruar nga punëdhënësi dhe i nënshtrohet tatimit mbi fitimin (IRPEF); taksa mbahet direkt nga INAIL, që i lëshon të aksidentuarit certifikatën përkatëse në lidhje me taksën.

### Shuma e kompensimit të përkohshëm:

| <i>ditë</i>  | <i>Kush paguan</i> | <i>Përqindja mbi pagën (e deklaruar nga punëdhënësi)</i> |
|--|--------------------|--|
| <b>Ditët e aksidentit</b>  | <b>punëdhënësi</b> | <b>100%</b>  |
| <b>Tre ditët që vijnë më pas</b>                                 | <b>punëdhënësi</b> | <b>60%</b>   |
| <b>Nga dita e 4<sup>të</sup> deri në ditën e 90<sup>të</sup></b> | <b>INAIL</b>       | <b>60%</b>   |
| <b>Nga dita e 91<sup>të</sup> deri në shërimin klinik</b>        | <b>INAIL</b>       | <b>75%</b>   |

Disa kontrata pune kolektive parashikojnë që punëdhënësi ta integrojë kompensimin e përkohshëm të paguar nga INAIL deri sa të arrijë në 100% të pagës.

## Si paguhet kompensimi i përkohshëm:

- pagesa bëhet në fund të kohës së aksidentit dhe çeku i dërgohet direkt të aksidentuarit në adresën e deklaruar në denoncimin e aksidentit.
- nganjëherë punëdhënësi i jep paradhënie punonjësit shumë që është në ngarkim të INAIL-it. Në këtë rast INAIL ia kthen paratë direkt punëdhënësit dhe jo punonjësit.

Për periudhat më të gjata të sëmundjes, në qoftë se punëdhënësi nuk ia jep paradhënie shumë e parave që është në ngarkim të INAIL-it, punonjësi mund të kërkojë, duke i telefonuar ose duke u paraqitur pranë zyrave të INAIL-it, që t'i jepen paradhënie.

**Ju kujtojmë se është shumë e rëndësishme që të lajmërojmë INAIL-in për çdo ndryshim adrese.**

## **VINI RE!**

**Për:**

- artizanët,
  - bashkëpunëtorët familjarë (bashkëpunëtorë familjarë, kujdestarë, shërbyes, etj.)
  - anëtarët e kooperativave
  - punëtorët në bujqësi,
- kompensimi i përkohshëm llogaritet mbi bazën e shumës së pagave të vendosura me ligj (paga konvencionale).**

## **SHËRBIMET SHËNDETËSORE:**

**Jepen nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (Servizio Sanitario Nazionale) dhe në disa ambulatorë të INAIL-it, të aktivizuar sipas marrëveshjeve përkatëse me Rajonet.**

## **CILAT JANË TË DREJTAT E MIA NË RAST INVALIDITETI TË PËRHERSHËM TË SHKAKTUAR NGA PUNA?**

**INAIL vlerëson dëmin psikofizik dhe i paguan punonjësit një kompensim në para.**

### **VLERËSIMI I DËMIT**

Në rast sëmundje profesionale dhe/ose aksidenti për shkak të punës, INAIL nëpërmjet mjekut të vet ligjor dhe, në qoftë se është e nevojshme nëpërmjet një ekipi me mjekë specialistë, vlerëson dëmin fizik dhe/ose psikik të përhershëm, sipas kriterëve të vendosura nga ligji italian. Ky vlerësim shprehet nëpërmjet numrave, nga 1% deri në 100%, që përfaqësojnë përqindjen e humbjes së integritetit psikofizik, ndaj një personi që konsiderohet i shëndetshëm (**dëm biologjik**).

### **KOMPENSIMI I DËMIT BIOLOGJIK:**

**SIPAS DISPOZITAVE DHE KRITEREVE TË LIGJIT ITALIAN, INAIL PAGUAN:**

- **Një shumë të vetme parash (Likuidim në kapital)**, në qoftë se dëmi fizik dhe/ose psikik është vlerësuar në një shkallë më të madhe se 5% dhe më të vogël se 16%.
- **Një shumë parash mujore (Kompensim në rentë)**, në qoftë se dëmi vlerësohet i barabartë ose më i madh se 16%.

INAIL paguan një shumë shtesë mbi rentën (**kuota integrale**), për gruan ose burrin dhe për fëmijët; **pra punonjësi duhet të lajmërojë INAIL-in në rast se ka ndryshime të përbërjes familjare (për shembull: martesë, lindje fëmijësh).**

Në rast invaliditeti tepër të rëndë të shkaktuar nga disa dëmtime që janë të përshkruara shprehimisht nga ligji, INAIL-i i jep çdo muaj, së bashku me rentën, një **“çek për asistencë personale të vazhdueshme”**.

**Renta INAIL nuk është subjekt tatimi (IRPEF) dhe personi ka gjithmonë të drejtë ta marrë, edhe në qoftë se nuk banon në Itali dhe transferohet në një vend tjetër ose kthehet në vendlindjen e vet.**

**Edhe në këtë rast, në qoftë se ndërrohet adresa është e nevojshme të lajmërohet INAIL-i.**

### **ÇFARË NDODH NË QOFTË SE KUSHTET E MIA SHËNDETËSORE TË DËMTUARA NGA AKSIDENTI NË PUNË OSE NGA SËMUNDJA PROFESIONALE KEQËSOHEN (OSE PËRMIRËSOHEN) PASI MË ËSHTË DHËNË RENTA?**

**Dëmi “biologjik” është subjekt i një vlerësimi të ri:**

- **me kërkesën e INAIL-it “revizionimi aktiv”,**
- **me kërkesën e të interesuarit “revizionimi pasiv”,**

**brenda periudhave të vendosura me ligj, si më poshtë**

|                        |  |
|------------------------|--|
| Aksidente në punë      | Maksimumi 10 vjet, nga data e krijimit të rentës |
| Sëmundje profesionale  | Maksimumi 15 vjet, nga data e krijimit të rentës |
| Silikozë dhe asbestozë | Pa kufi në kohë                                  |

Renta shton, zvogëlon ose mbetet e njëjtë në bazë të vlerësimi të ri të dëmit. Renta nuk paguhet më në qoftë se INAIL-i vërteton një përmirësim që zvogëlon dëmin në një shkallë më të vogël se 16%.

## SHËRBIME TË TJERA

### **Shëndetësore për integrim shoqëror – pune**

Përveç shërbimeve me para, INAIL-i ndërhyr nëpërmjet një ekipi shumëdisiplinor të përbërë nga një mjek, një asistent social dhe një përgjegjës administrativ, për të lehtësuar rehabilitimin, integrimin shoqëror dhe në punë, të personave që kanë pësuar një dëm nga aksidenti në punë dhe/ose sëmundja profesionale.

Përsa i përket projekteve të integritit dhe rehabilitimit, INAIL-i jep:

- **proteza** për të zëvendësuar pjesët e trupit që mungojnë (për shembull: gjymtyrë artificiale),
- **orteza** për të përmirësuar funksionin e pjesëve të trupit që paraqesin mungesa funksionesh **të përhershme** (për shembull: tutore dhe buste 'korsé ortopedike', që duhet të përdoren për të gjithë jetën),
- **ndihmëse teknike, vegla dhe aparate** të dobishme për të përmirësuar cilësinë e jetës, gjithashtu në lidhje me lëvizshmërinë e personit të paaftë (për shembull: shtretër, karroceta ortopedike, elevator për të sëmurë, mjete ndihmëse informatike, përshtatëse për automobila, etj.),
- **kontribute** për eliminimin e pengesave arkitektonike, në shtëpinë e banimit të personave të paaftë me vështirësi të rënda lëvizore (për shembull: pedana për ngjitjen e shkallëve, përshtatje për shërbimet higjienike).
- **llixhat** (kurat termale), kur janë të nevojshme për tipin e paaftësisë së shkaktuar nga puna dhe brenda afateve të caktuara të vendosura nga ligji.

## VDEKJA E PUNONJËSIT OSE E PERSONIT QË KA PËRFITUAR RENTËN INAIL PËR SHKAK TË AKSIDENTIT OSE TË SËMUNDJES PROFESIONALE:

### Renta për të mbijetuarit dhe Çeku i funeralit

Në rast vdekje të punonjësit për shkaqe pune (aksident, aksident gjatë rrugës për në punë, sëmundje profesionale), INAIL-i i paguan një shumë mujore parash bashkëshortit (gruas ose burrit) që është i njohur ligjërisht sipas ligjit italian dhe fëmijëve, deri sa të arrijnë moshën 18 vjeç (moshë madhore). Bashkëshorti (gruaja ose burri) humbet të drejtën e rentës vetëm në rast se martohet përsëri.

Renta për të mbijetuarit u paguhet edhe fëmijëve studentë në moshë madhore, që nuk kanë të ardhura personale dhe fëmijëve në moshë madhore që janë krejtësisht të paafët.

Në mungesë të fëmijëve dhe të bashkëshortit, renta mund t'u paguhet prindërve vetëm atëherë kur mund të vërtetohet se, duke mos pasur mjetet e mjaftueshme, jetonin me paratë e të birit ose të bijës së vdekur për shkak pune.

**Çeku i funeralit** është një shumë parash, e vendosur me ligj, që INAIL-i u paguan familjarëve të punonjësit që ka vdekur, ose kujtdo që vërteton se ka përballuar shpenzimet e funeralit.

### **KUNDËRSHTIMI PËR VENDIMET E INAIL-it**

Në qoftë se punonjësi ose familjarët e tij, që kanë mbijetuar, nuk janë dakord me atë çfarë është vendosur nga INAIL-i, mund t'i drejtohen një "Patronati".

Në fakt në Itali ka disa Ente, që quhen Patronati (patronazhe), të cilat mbrojnë në mënyrë të veçantë interesat e punonjësve.

Asistenca e këtyre Enteve është **pa pagesë**.



## UFFICI INAIL PRESENTI NELLA REGIONE PIEMONTE

| SEDE INAIL        | INDIRIZZO               | CAP.  | TELEFONO    | FAX         | E-MAIL                     |
|-------------------|-------------------------|-------|-------------|-------------|----------------------------|
| ALESSANDRIA       | Via A. Gramsci, 2       | 15100 | 0131/316211 | 0131/316222 | alessandria@inail.it       |
| ASTI              | Via Goito, 2            | 14100 | 0141/380511 | 0141/380550 | asti@inail.it              |
| BIELLA            | Via Aldo Moro, 4        | 13900 | 015/3580511 | 015/3580526 | biella@inail.it            |
| CUNEO             | Via Luigi Einaudi, 30   | 12100 | 0171/314511 | 0171/314556 | cuneo@inail.it             |
| IVREA             | V. Circonvallazione,    | 10015 | 0125/233511 | 125/233512  | ivrea@inail.it             |
| GRAVELLONA TOCE   | C.so G. Marconi, 99     | 28883 | 0323/849111 | 0323/840771 | verbanocusioosola@inail.it |
| NOVARA            | Via Andrea Costa, 33    | 28100 | 0321/617411 | 0321/398332 | novara@inail.it            |
| TORINO CENTRO     | C.so G. Ferraris, 1     | 10121 | 011/55931   | 011/5593321 | torinocentro@inail.it      |
| TORINO NORD       | Via B. Ramazzini, 26    | 10154 | 011/55931   | 011/5593071 | torinonord@inail.it        |
| TORINO SUD        | C.so Orbassano, 366     | 10137 | 011/55931   | 011/5593681 | torinosud@inail.it         |
| PINEROLO          | Via Martiri del XXI, 92 | 10064 | 0121/394211 | 0121/394355 | pinerolo@inail.it          |
| VERCELLI          | Via Pirandello, 18/A    | 13100 | 0161/226511 | 0161/226519 | vercelli@inail.it          |
| MONCALIERI        | Via Ungaretti, 27       | 10024 | 011/55931   | 011/5593910 | moncalieri@inail.it        |
| RIVOLI            | Via Adige, 9            | 10090 | 011/9519211 | 011/9519250 | torino7@inail.it           |
| CASALE MONFERRATO | Via B.Buozzi, 18/B      | 15033 | 0142/433231 | 0142/433233 | casalemonferrato@inail.it  |
| NOVI LIGURE       | Via Tortona, 2          | 15067 | 0143/334211 | 0143/322090 | noviligure@inail.it        |
| ALBA              | Via Rattazzi, 10        | 12051 | 0173/444511 | 0173/444555 | alba@inail.it              |
| SALUZZO           | Via Fiume, 11           | 12037 | 0175/210611 | 0175210620  | saluzzo@inail.it           |
| DOMODOSSOLA       | Piazza G. Matteotti, 38 | 28037 | 0324/220511 | 0324/220536 | domodossola@inail.it       |
| CHIVASSO          | Via Boris Bradac, 43    | 10034 | 011/9119511 | 011/9119522 | chivasso@inail.it          |
| CIRIE'            | Via Andrea d'Oria, 16   | 10073 | 011/9200611 | 011/9200609 | cirie@inail.it             |